



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 21-22
Tarih/Dt.	04.03.2022

Referenca : 626-21-027-1-1-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01, neni 18, dhe neni 41 në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 8 paragrafi 8.1 dhe pika 8.1.1 bie këtë:

V E N D I M

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “MADEKOS” SH .P.K. – Fushë Kosovë e parashtruar me datën 03.03.2022 përmes platformës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-21-10608-1-1-1 nr. të brendshëm 626-21-027-1-1-1 dhe titull: “FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË”

II

Vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 28.02.2022 me të cilin është shpërblyer me kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX.IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik “MADEKOS” SH.P.K. me datë 03.03.2022 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës.

Si Autoritet Kontraktues, pas pranimit të kërkesës brenda afatit ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga O.E. “MADEKOS”

SH .P.K. i cili në deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet pretendon se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-s të parashikuara në nenet: 1, 6, 7, 56, 59, 60, 65, 66 dhe 69.

Si autoritet kontraktues në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk e ka vendosur kërkesën për afatin e liferimit në dosje të tenderit është i pa bazë, pasi që një kërkesë e tillë ka qenë e vendosur në nenin 5.5 të Dosjes së Tenderit në Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FDT) në të cilën në mënyrë shumë të qartë dhe decitive, është kërkuar që:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit.

-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë nga data e porosisë.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Pra në bazë të kësaj kërkesë Operatorët Ekonomik janë të obliguar që të dorëzojnë afatin e liferimit jo më të gjatë se 5 (pesë) ditë nga data e porosisë sikur është kërkuar në dosje të tenderit, ndërsa O.E. ankues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë dhe si pasojë tenderi i është refuzuar si i pa përgjegjshëm, sikur është paralajmëruar në dosje të tenderit në nenin 5.5 të FDT-s.

Dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Në bazë të nenit 27 të LPP-s në fuqi dhe në bazë të nenit 18 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit, zyrtari kryesor i prokurimit, është përgjegjës për hartimin e dosjes së tenderi. Dosja e tenderit është një formular draft i aprovuar nga KRPP e cila duhet të modifikohet dhe të vendosen kushtet dhe kriteret si dhe të jepen informatat e sakta për Operatorët Ekonomik. Për tenderin në fjalë, është shkarkuar dosja e tenderit nga platforma elektronike e prokurimit dhe e njëjta është hartuar në bazë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Në nenin 18 paragrafi 18.3 të RRUOP është cekur se Struktura e dosjes së tenderit përbëhet nga tri pjesë:

PJESA A – Procedura e tenderimit

PJESA B – Draft Kontrata

PJESA C – Formulari i Tenderit

Pjesa A, procedurat e tenderimit, përbëhet nga dy pjesë:

Udhëzimet për ofertuesit

Fleta e të dhënave të tenderit dhe anekset

Udhëzimi për ofertuesit është një formë standarde që nuk ka nevojë të plotësohet nga AK.

Zyrtari i prokurimit duhet të plotësojnë fletën e të dhënave të tenderit për secilin aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu në nenin 18 paragrafi 18.13 është paraparë se cilat informatat janë të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së tenderit, ndër të cilat në formë tabelore në pikën (q) është paraparë që në dosje të tenderit duhet të paraqiten kushtet e kërkuara të dorëzimit dhe periudha e dorëzimit të

cilat në tenderin në fjalë janë paraqitur në dosje të tenderit konkretisht në FDT tek Kushtet dhe kërkesat e dërgesës në nenin 5.5.

Sa i përket pretendimit se kërkesa nuk është paraqitur: -As tek kërkesat e pranueshmërisë – as tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – as tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe as tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, duhet të sqarohet se kërkesa e tillë është kërkesë e cila hynë tek kërkesat formale administrative sikur është paraparë në nenin 43 paragrafi 41.13 pika 1. dhe jo kërkesë minimale e kualifikimit të cilat hynë në pikat të cilat i kemi cekur më lartë e të cilat janë paraparë në pikën 2 nenin 43 paragrafi 41.13. Gjithashtu në nenin 41 paragrafi 41.5 në pikën a. është paraparë që tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur i njëjti është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderi. Duhet të theksojmë gjithashtu se O.E. ankues është i vetmi tenderues pjesëmarrës që nuk e ka dorëzuar dokumentin në fjalë ndërsa të gjithë O.E. tjerë pjesëmarrës kanë dorëzuar afatin e liferimit sikur është kërkuar në dosje të tenderit.

Gjithashtu operatori ekonomik ankues, nëse ka pasur diçka të pa qartë, ka mundur që të kërkojë informata shtesë sqaruese në lidhje me kërkesën e paraqitur në dosje të tenderit, duke u bazuar në nenin 25 të RRUOP-së si dhe duke u bazuar në neni 16.1 të dosjes së tenderit deri me datën 20.01.2022 ora 14:00. Mirëpo ne nuk kemi marr kurrfarë kërkesë për informata shtesë sqaruese nga asnjë O.E. gjatë periudhës së cekur më lartë. Në ftesën për tender i kemi njoftuar të gjitha palët e interesuara që në rast të dështimit të dorëzimit të tenderit tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, tenderi do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “ tender i papërgjegjshëm”

Pretendimi se është shkelur neni 56 paragrafi 3 i LPP-s gjithashtu është i pa bazuar pasi që sikur kemi sqaruar më lartë kërkesa është paraparë në nenin 5.5 të FDT.

Pretendimi i O.E. që ne nuk kemi pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të drejtë dhe efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike, nuk qëndron. Ne si Autoritet Kontraktues e kemi zhvilluar procedurën në fjalë duke u bazuar në dispozitat e nenit 1 si dhe në dispozitat tjera të LPP-s në mënyrë të hapur të paanshme dhe transparente. Pra pretendimi nuk qëndron pasi që në tërësi janë respektuar dispozitat e këtij neni. Do të vinte në shprehje shkelja e këtij neni po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, mirëpo me qenë se nuk i ka plotësuar kërkesat në dosje të tenderit, është konsideruar si O.E. i pa përgjegjshëm.

Edhe sa i përket pretendimit se është shkelur neni 6 i LPP-së pretendimi i O.E. është i pa bazuar pasi që në nenin 59 të LPP-s si dhe në nenin 41 të RRUOP-së është paraparë që vetëm O.E. të cilët i plotësojnë kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë do të konsiderohen të përgjegjshëm. Edhe në këtë rast do të vinte në shprehje shkelja e këtij neni po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi që procedura është zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente. Për prokurimin në fjalë, është përdorur procedura e hapur. Hapja e tenderit është bërë në mënyrë publike. Vlerësimi është bërë në mënyrë profesionale duke i trajtuar të gjithë O.E. në mënyrë të barabartë. Operatori Ekonomik nuk ka pasur kurrfarë vërejtje për kritere diskriminuese gjatë shpalljes së tenderit. Me datë 01.03.2022 ka kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik, me ç'rast i është dhënë qasje në ofertën e grupit të O.E. të rekomanduar si dhe është njoftuar që mund të ketë qasje në të gjitha dokumentet tjera të procedurës në fjalë. Në fund të procesverbalit përfaqësuesi i O.E. ankues ka konfirmuar që nuk ka ndonjë vërejtje. Andaj pretendimi që janë shkelur dispozitat e nenit 7 është i pa bazë.

Më tej, O.E. ankues në kërkesën e tij, pretendon se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 60 të LPP-s duke konsideruar që nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm** me çmimin më të ulët. Sikur kemi sqaruar më lartë edhe në këtë rast do të vinte në shprehje shkelja e këtij neni po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë si dhe në dispozitat në fuqi të Legjislacionit të Prokurimit Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me dt. 04.03.2022

Në M a m u sh ë

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.